



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Bushati në SEECP: Shqipëria po përmbush kushtet për çeljen e negociatave

2017-09-05 13:31:00



Në kuadër të vizitës në Slloveni, Ministri Bushati mori pjesë në takimim e Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Bashkëpunimit të Europës Jug-Lindore.

Gjatë fjalës së tij, Ministri Bushati falenderoi palën sllovene për mbështetjen e saj të pakushtëzuar në procesin e Integritimit të Shqipërisë dhe rajonit.

Më tej, Ministri Bushati nënvizoi tre rreziqet imediate që i kanosen rajonit. "Rreziku i parë është që zgjerimi mos të konsiderohet më si objektiv parësor i përbashkët, rreziku i dytë është që rritja e bashkëpunimit politik në rajon të mos ketë impakt konkret në jetën e qytetarëve tanë; ndërsa rreziku i tretë ka të bëjë me tendencën e re për të sakrifikuar shtetin ligjor në altar të stabilitetit", tha Bushati.

Krahas bisedimeve për ritmin dhe cilësinë e procesit të integritimit, Ministri Bushati u shpreh se "ka ardhur koha që ky proces të ketë një kalendar dhe afate".

Përgjatë konferencës ministrore, në një takim me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së, Federica Mogherini, Ministri Bushati shprehu besimin se progresi i Shqipërisë në zbatimin e reformës në drejtësi dhe prioritetet e qarta të qeverisë së re shqiptare në fushën e integritimit, krijojnë kushtet të mira për çeljen e negociatave për anëtarësim.